



MTI sqaron se nuk ka asnjë garë për dhënien me koncesion të shërbimit të lejeve të qarkullimit

2017-07-31 12:53:00

Zyra e shtypit

Në lidhje me lajmin e pasqyruar në disa media se shërbimi i lejeve të qarkullimit do të jepet me koncesion, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës sqaron se nuk ka shpallur asnjë garë për dhënien me koncesion të këtij shërbimi.

MTI, sqaron se shqyrtimi i kërkesave për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në ligj dhe vendimet e Qeverisë përmes partneritetit publik-privat, janë detyrim i institucionit përgjegjës dhe Agjensisë të Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).